

**STATUTI DHE AKT THEMELIMIN I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË**  
**KUFIZUAR**  
**“ARC Co-working” sh.p.k**

*Neni 1*

*Themeli*

Shoqëria “ARC Co-working” sh.p.k themelohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në zbatim të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” me ortakët:

**Znj. Astera Tola**, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr. BB3606687 të pasaportës, lindur në Potgozhan, me ditëlindje **01.05.1993** dhe banuese në Tiranë, Shqipëri.

**Znj. Silena Tola**, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr. BE5860626 të pasaportës, lindur në Polican, me ditëlindje **02.08.1989** dhe banuese në Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentat themeluese.

Shoqëria “ARC Co-working” sh.p.k themelohet më datë **06/10/2023**.

Kjo shoqëri fiton zotësinë për të vepruar pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Tiranë, qendër e cila pas miratimit të regjistrimit të shoqërisë e pajis atë edhe me NUIS-in përkatës identifikues.

*Neni 2*

*Forma e shoqërisë*

Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë me perjegjesi te kufizuar, për sa kohë asambleja e ortakëve nuk do të marrë një vendim për shndërrimin e saj.

*Neni 3*

*Emërtimi i shoqërisë*

Emërtimi i shoqërisë është “**ARC Co-working**” sh.p.k.

Në të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqëria, emërtimi i shoqërisë do të ndiqet nga fjalët “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” ose inicialet Sh.p.k.

*Neni 4*

*Selia e shoqërisë*

Shoqëria e ka selinë në qytetin e Tiranës, në adresën: **Rruga e Bogdanëve, Ndërtesa nr. 76, Hyrja nr. 2, Njësia bashkiake nr.10, Tiranë**. Selia mund të transferohet në çdo vend tjeter brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me një vendim të vet dhe rast pas rasti ajo mund të krijojë ose anullojë seli dytësore administrative, drejtori, filial, degë, agjensi dhe zyra, brenda ose jashtë territorit të Republikës të Shqipërisë.

### *Neni 5*

#### *Objekti i veprimitarisë*

Shoqëria do të ushtrojë veprimtari në fushën e hapësirave të përbashkëta të punës, duke ofruar postacione pune dhe shërbime të lidhura me to, si përdorimi i pajisjeve teknologjike të zyrës, përdorimi i sallave dhe hapësirave të tjera të zyrës, dhënia me qira e ambienteve pér subjekte të tjera tregtare, organizatave jo-sitimprurëse dhe çdo personi të interesuar.

Gjithashtu shoqëria do të ofrojë kurse pér grup-mosha të ndryshme, si dhe pjesë e veprimitarisë së saj do të jenë përgatitja dhe mirëmbajtja e faqeve të internetit, ofrimi domain, shërbimin e web hosting, ndërtim softëare, ndërtim faqe web, programme të ndryshme, konsulenca, databaza, përgatitja dhe mirëmbajtja e rrjeteve sociale në internet, si dhe marketingu online, mirëmbajtja dhe riparimi i kompjuterave dhe rrjeteve të komunikimit, etj.

Shoqëria do të kryejë pa kufizim çdo aktivitet tjeter të lejueshëm nga legjislacioni në fuqi edhe pse jo i përmendur në këtë akt.

### *Neni 6*

#### *Kohëzgjatja e shoqërisë*

Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar, duke filluar që nga data e regjistrimit të saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Me vendim të ortakeve, shoqëria mund vodosë kufizim kohor në veprimtarinë e saj ose ta mbyllë veprimtarinë e saj kur e sheh të arsyeshme, apo janë rastet e parashikuara nga ligji.

## ***KAPITALI THEMELTAR; KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE***

### *Neni 7*

#### *Kapitali themeltar*

Kapitali themeltar fillestar është fiksuar në vlerën 100.000 lekë të reja..

Ortakët e shoqërisë zotërojnë secili nga (1) kuotë të shoqërisë.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin themeltar të shoqërise është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- ✓ Ortaku themelues Znj. Astera Tola: zotërues i 1 (një) kuote e barabartë kjo me vlerë të përgjithshme 40.000 lekë (dyzetë mijë lekë) që përbën 40 (dyzetë) % të kapitalit themeltar të nënshkruar të shoqërisë.
- ✓ Ortaku themelues Znj. Silena Tola: zotërues i 1 (një) kuote e barabartë kjo me vlerë të përgjithshme 60.000 lekë (gjashtëdhjetë mijë lekë) që përbën 60 (gjahtëdhjetë) % të kapitalit themeltar të nënshkruar të shoqërisë.

Kapitali mund të zmadhohet dhe të zvogëlohet me vendim të ortakeve.

### *Neni 8*

#### *Kuotat, fitimi dhe kalimi i tyre*

Kuotat e pjesëmarrjes janë në zotërim të:

- ✓ Ortaku themelues Znj. Astera Tola: zotëruar i 1 (një) kuote e barabartë kjo me vlerë të përgjithshme 40.000 lekë (dyzetë mijë lekë) që përbën 40 (dyzetë ) % të kapitalit themeltar të nënshkruar të shoqërisë.
- ✓ Ortaku themelues Znj. Silena Tola: zotëruar i 1 (një) kuote e barabartë kjo me vlerë të përgjithshme 60.000 lekë (gjashtëdhjetë mijë lekë) që përbën 60 (gjashtëdhjetë ) % të kapitalit themeltar të nënshkruar të shoqërisë.

Kalimi dhe fitimi i kuotave të shoqërisë do të kryhet në përputhje me nenet 72-75 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

### *Neni 9*

#### *Transferimi i kuotave dhe zmadhimi i kapitalit*

Kuotat e kapitalit themeltar janë lirisht të trasferueshme edhe në rrugë trashëgimie, apo ndarje pasurore mes bashkëshortëve.

Transferimi i kuotave të kapitalit themeltar të secilit ortak themelues, në persona të tjera jo ortakë të shoqërisë do të bëhet vetëm me miratimin e vendimit të asamblesë së ortakëve.

Ortakët e kësaj shoqërie, mund të vendosin të shtojnë kapitalin themeltar të shoqërisë në çdo periudhë që e shohin të nevojshme. Zmadhimi apo zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë do të bëhet sipas parashikimeve të këtij Statuti dhe nenit 81 të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

## **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

### *Neni 10*

#### *Të drejtat dhe detyrat*

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve;
- d) Emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendor në shkronjat c dhe d, të kësaj pike;
- f) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimitarisë;
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë të veprimitarisë;
- h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

- l) Krijimin e fondeve, përbërjen, madhësinë, burimet e krijimit, mënyra dhe kushtet e përdorimit;
- m) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

### *Neni 11*

#### *Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme*

Asambleja e Përgjithshme mblidhet në mbledhje të zakonshme dhe të jashtëzakonshme. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit ndërsa mbledhjet e jashtëzakonshme bëhen sa herë çmohet e nevojshme nga ortaket. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratori apo ortakët sipas nenit 84 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

### *Neni 12*

#### *Përfaqësimi në Asamble*

Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi perfaqësimi notarial nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### *Neni 13*

#### *Kuorumi*

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve ne kete statut.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumin të përmendur në pikën I të këtij nenit, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### *Neni 14*

#### *Marrja e vendimeve*

Me përashtim të rasteve kur ky statut parashikon një shumicë më të lartë, Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë statut ose në ligj për çështjet e tjera, Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

Emërimi dhe/o se shkarkimi i administratorëve dhe ekspertit kontabël dhe përcaktimi i shpërblimit të tyre do të bëhet sipas ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare."

Asambleja e Pergjithshme për çështjet e mëposhtme vendos me votën pro të ortakeve që përfaqësojnë të paktën 75% të kapitalit themeltar të shoqërisë:

- Miratimi i bilancit;
- Shpérndarja e dividenteve;
- Emërimi dhe shkarkimi i personit që do të merret me kontabilitetin e shoqërisë;
- Miratimin i buxhetit vjetor;
- Autorizimin për nënshkrimin e çfarëdo lloj kontrate;
- Miratimi i kërkesës për përjashtimin e njërit prej ortakëve;
- Ndryshimet e statutit;
- Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit;
- Përfaqësimi i shoqërisë në gjykatë;
- Riorganizimi dhe prishja e shoqërisë.

*Neni 15  
E drejta e votës*

Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.

Ortakët, që nuk janë të pranishëm, mund të marrin pjesë në nëpërmjet mjeteve të ndryshme të komunikimit, përfshirë mjetet elektronike.

Mjetet elektronike të lejuara janë:

- a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;
- b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër;
- c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpala apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së Asamblesë se Përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.

Përdorimi i ketyre mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e tyre dhe sigurinë e komunikimeve elektronike.

Ortakët kanë të drejtën, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që marrëveshja të bëhet me shkrim.

### *Neni 16*

#### *Përjashtimi nga e drejta e votës*

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesit, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### *Neni 17*

#### *Proçesverbalet e mbledhjes së Asamblesë*

Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të ketyre proçesverbaleve.

Proçesverbali duhet të përbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe mbajtësit të proçesverbalit, rezultatet e votimit.

Proçesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme.

Proçesverbali i mbledhjes nënshkruehet nga kryetari dhe nga mbajtësi i proçesverbalit.

### *Neni 18*

#### *Hetimet e posaçmës*

Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçmës për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.

Ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në Asamblënë e shoqërisë, dhe/ose cilido kreditor i shoqërisë mund t'i kërkojnë Asamblesë së Përgjithshme emërimin e një eksperti të pavarur të fushës, kur ka dyshime të bazuara për shkelje të ligjit ose të statutit. Ortakët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga Asambleja për emërimin e ekspertit të pavarur, mund t'i kërkojnë gjykatës emërimin e këtij eksperti. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, kërkesa e ortakëve vlerësohet e refuzuar.

Kur Asambleja e Përgjithshme ka emëruar një ekspert të fushës për kryerjen e hetimit të posaçmës dhe kur për këtë emërim ka dyshime të bazuara për të besuar se eksperti mund të mos realizojë hetimin e posaçmës në mënyrën e duhur, ortaku ose kreditorët e përmendur në pikën 2 të këtij nenit mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e tij.

### *Neni 19*

#### *Shfuqizimi i vendimeve të parregullta dhe dëmshperblimi*

Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës përkatëse shfuqizimin e vendimeve të administratorit kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit ose të statutit.

Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 pér qind të totalit të votave në Asamblenë e shoqërisë, apo secili prej kreditorëve të shoqërisë mund t'i kërkojnë Asamblesë së Përgjithshme ngritjen e padisë si më sipër. Ortakët apo kreditorët e shoqërisë së përcaktuar më sipër, brenda 30 ditëve pas refuzimit nga asambleja për ngritjen e padisë, kanë të drejtë të ngrenë padi drejtpërdrejt përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimit të administratorëve. Nëse asambleja e përgjithshme nuk merr një vendim, brenda 60 ditëve nga data e kërkesës, kërkesa e ortakëve apo kreditorëve vlerësohet e refuzuar.

Në rastet kur shoqëria ngre padi per rastin e mesipërm përfaqësuesi i posaçëm, me anë te te cilit do te mare pjese ne gjykim, do të caktohet nga Asambleja e Përgjithshme.

Ortakët ose kreditorët e përmendur në pikën 2 të këtij neni mund t'i kërkojnë gjykatës zëvendësimin e përfaqësuesit të posaçëm, kur ka dyshime të bazuara se ai mund të mos ngrëjë e ndjekë padinë në interesin më të mirë të shoqërisë. Nëse gjykata e pranon këtë kërkesë, kostot e emërimit dhe të shpërblimit të përfaqësuesit përballohen nga shoqëria.

Gjykata vendos shpalljen e pavlefshmërisë së vendimit të administratorëve, nëse këta nuk merren vesh, me pajtim, me përfaqësuesin e posaçëm pér korrigimin e pasojave të vendimit, brenda 30 ditëve nga data e emërimit të këtij përfaqësuesi. Të drejtat e palëve të treta mbeten të pacenuara.

Ortakët në pakicë dhe kreditorët e përcaktuar më sipër kanë të drejtat e parashikuara në pikat 2 e 4 të këtij neni, edhe në rastin kur Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim, ose refuzon të vendosë pér kërkesën e tyre ndaj administratorëve për ngritjen e padisë, me objekt shpërblimin e dëmit të pësuar nga shoqëria, si vendim i paligjshëm, apo pér ngritjen e padive të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve.

### *Neni 20*

#### *Të drejtat e lidhura me kuotën*

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cënimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasoje e cënimit të këtyre të drejtave.

### **ADMINISTRATORI**

#### *Neni 21*

#### *Emërimi, shkarkimi, të drejtat dhe detyrimet*

Ortaku i vetëm apo Asambleja e Përgjithshme emëron një person fizik si administrator të shoqërisë pér një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë riemërimi.

Administratori i një shoqërie tregtarë mëmë, nuk mund të emërohen si administrator i kësaj shoqërie.

Administratori/ët të detyrohet të:

a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;

- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut të vetëm që ushtron detyrat e Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj.

Në rastet e parashikuara nga statuti dhe në rastet e tjera te parashikuara në ligj, administratori është i detyruar të paraqesë raport te ortaku i vetëm apo të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme në rast se do të ketë shtim të ortakëve të shoqërisë.

Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojet administratorin në çdo kohë me shumicë te zakonshme.

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Administrator i shoqërisë është z. *Glisav Katroshi*, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr. BD4847924 të pasaportës, lindur në Tiranë, me ditëlindje **10/05/1993** dhe banues në Tiranë, Shqipëri.

### ***Neni 22*** ***Përfaqësimi***

Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorit i kundrejtohen palëve të treta.

Administratori mund të nënshkruajë kontrata vetëm pasi të jenë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme/Ortaku i vetëm.

### ***Neni 23*** ***Shpërbimi***

Shpërbimit bazë të administratorëve mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme.

Shpërbimi, sipas pikës 1 të këtij nenit, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërbimit të administratorëve në masën e përshtatshme.

Kriteret e shpërbimit, shpërbimi individual dhe efekti vjetor i shpërbimit të administratorëve në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

## *Neni 24*

### *Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia*

Administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsë, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanjojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të garantojë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të statutit dhe ligjit;
- dh) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshëm;

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ketij statuti kryejë veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

## *KREU V PUNËSIMI NË SHOQËRI*

## *Neni 25*

### *Zbatimi i legjislacionit të punës*

Për ushtrimin e veprimatrissë së saj shoqëria ka të drejtë të marrë në punë punonjës, punësimi i të cilëve bëhet sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin e punës të Republikës të Shqipërisë, në këtë statut dhe në kontratën përkatëse të punësimit.

Shoqëria ka detyrimin tu garantojë punëmarrësve kushte punë të përshtatshme, sipas kërkesës të vendit të punës, mjete të nevojshme për realizimin e detyrave, si dhe përfitimet e tjera që u garantohen prej ligjit.

#### *Neni 26*

##### *Disiplina në punë*

Punëmarrësi ka për detyrë të respektojë disiplinën në punë gjatë kohëzgjatjes të punës ose në lidhje me të.

Ortaku i vetëm/Asambleja ka të drejtë të hartojë për këtë qëllim rregulloren e brendshme të punës, e cila duhet të respektohet me përpikmëri nga të dy palët. Punëmarrësi përgjigjet për dëmet që i shkakton shoqërisë me faj gjatë punës.

#### *KREU VI*

##### *PRISHJA E SHOQËRISË*

#### *Neni 27*

##### *Shkaqet e prishjes së shoqërisë*

Kjo shoqëri prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në këtë statut;
- b) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme/Ortakut të vetëm;
- c) kur nuk mund të realizohet objekti i Shoqërisë i parashikuar në statut;
- ç) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtarë për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës.

#### *Neni 28*

##### *Shndërrimi i shoqërisë*

Shoqëria mund të shndërrohet në shoqëri kolektive, komandite ose anonime vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme/Ortakut të vetëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### *Neni 29*

##### *Likuidimi në gjendjen e aftësisë paguese*

Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas parashikime të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Për kryerjen e procesit te likuidimit, Ortaku i vetëm/Asambleja e Përgjithshme emëron likuiduesin i cili paraqet një raport mbi gjendjen e aktivit dhe të pasivit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe asfatin e përfundimit të tyre.

Më përfundimin e procesit të likuidimit ortaku i vetëm për bilancin finansiar perfundimtar, për rregullshmérinë e likuiduesit, për heqjen e mandatit të tij si likuidator, si dhe për mbylljen e procesit të likuidimit.

## **KREU VII** **LARGIMI DHE PËRJASHTIMI I ORTAKËVE**

### *Neni 30*

#### *Largimi i ortakut për shkaqe të arsyeshme*

Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.

Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtrojë shkaqet e largimit.

Administratorët duhet të thërrasin mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dijeni për njoftimin e largimit, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme.

Ortaku ka të drejtë të ngrëjë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit Asambleja e Përgjithshme nuk mblidhet apo nuk njeh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës.

Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse rezulton se largimi është kryer në bazë të shkaqeve të paarsyeshme.

Ortaku që largohet ka të drejtë të ngrëjë padi ndaj shoqërisë dhe/ose ortakëve të tjerë që shkaktuan largimin e tij dhe të kërkojë ndaj tyre, në mënyrë solidare, shpërblimin e dëmit të pësuar.

### *Neni 31*

#### *Përjashtimi i ortakut*

Asambleja e Përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim.

Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, sipas pikës 1 të këtij nenit, rastet kur ortaku:

- me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;
- me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;
- përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut;

ç) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë.

Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin.

Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar.

Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngre ndaj tij padi për shpërblim dëmi, ortaku ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përsitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria.

*Neni 32*

*Pasojat e largimit dhe përjashtimit*

Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhen në datën e largimit ose të vendimit të formës së prerë të gjykatës për largimin ose përjashtimin.

***DISPOZITA TË FUNDIT***

Çështjet që nuk trajtohen në këtë statut, rregullohen nga legjislacioni tregtar shqiptar në fuqi.

Tiranë, më 06/10//2023

**ORTAKËT:**

**ASTERA TOLA**



**SILENA TOLA**

